



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 647/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet BPrAL "Kosovo Art Academy" në nivel institucional dhe për programet e studimit:

- Fotografi, BA, 180 ECTS;
- Dizajn, BA, 180 ECTS;
- Grafik Dizajn Multimedial, BA, 180 ECTS

A r s y e t i m i

BPrAL "Kosovo Art Academy" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim institucional dhe të programeve të studimit:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Dizajn	BA	180	Ilir Muharremi, Elida Zeqo Miraj, Dr. Ajhan Bajmaku
2	Fotografi	BA	180	Gureta Bajrami Breznica, Afrim Spahiu, Albana Vrapit
3	Grafik Dizajn Multimedial	BA	180	Shpend Bengu, Prof. Dr. Hivzi Muharremi, Prof. Dr. Rrezeart Galica

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL "Kosovo Art Academy", dhe pas shqyrtimit të rekomandimeve përfundimtare të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL "Kosovo Art Academy" me 23.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ms. Doris Carstensen, dhe Ms. Bettina Henkel. Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Për sa i përket **akreditimit institucional**, Ekipi i Ekspertëve ka dyshime për autonominë institucionale të Kosovo Art Academy. Të gjeturat gjatë vizitës së ekspertëve tregojnë se ekipi i KAA-së ka transferuar konceptet dhe plan programet nga Shkolla Italiane LABA pa i adoptuar ato me standardet dhe kërkesat e Kosovë për Arsim të Lartë. Autonomia në strategji, planifikim akademik, vendim - marrje, financa dhe buxhet, si dhe infrastruktura adekuate nuk kanë qenë të pranueshme për ekspertët. Ekspertët nuk kanë gjetur ndonjë analizë të tregut të punës, si dhe strategjia planifikuese për ofrim të mësimdhënies dhe arsimit cilësor mungonte plotësisht.

Në lidhje me **hapësirat**, Ekipi i Ekspertëve ka thënë se infrastruktura e specializuar për sa i përket kërkesave për programet e planifikuara akademike dhe hulumtim nuk është planifikuar me kujdes nga KAA. Sipas ekspertëve, sallat e planifikuara, infrastruktura dhe pajisjet e prezantuara teknologjike nuk përmbushin kërkesat e programeve të studimit.

Në lidhje me **programet e studimit**, Ekipi i Ekspertëve konsideron se programet e prezantuara janë më tepër programe profesionale sesa akademike dhe se këto programe i takojnë nivelit 5 (ciklit të shkurtër) të KKK-së. Sipas ekspertëve, ka dyshime të arsyeshme për cilësinë dhe sasisë e lëndëve të ofruara brenda programeve BA. Nëse këto programe duhet të jenë të nivelit BA dhe në përputhje me standardet evropiane, ekspertët kanë thënë se ato duhet të rishikohen thellësisht me qëllim të përshtatjes me nivelin BA. Profili akademik i programeve është i ulët dhe nuk është i kuptueshëm për nivelin BA, apo studime universitare, si dhe kualifikimet akademike nuk përkojnë me kualifikimet universitare.


Në lidhje me **metodat e mësimdhënies** dhe konceptin didaktik, ekspertët kanë thënë se këto dy elemente nuk janë specifikuar në përshkrimet e lëndëve dhe as në syllabuset e lëndëve. Në syllabuse ekspertët kanë vërejtur një përzierje të formave të ndryshme të mësimdhënies (të kopjuara) mirëpo nuk kanë vërejtur ndonjë metodologji të saktë. Për sa i përket **kalkulimit të ECTS-ve**, ekspertët kanë konstatuar se kalkulimi i ngarkesës së studentëve për programet e studimit nuk është bërë në përputhje me rregulloret për arsim të lartë në Kosovë dhe as në përputhje me standardet evropiane, përkatësisht Udhëzuesit Evropian për ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL "Kosovo Art Academy"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

